

VENDIM
Nr. 69, datë 13.2.2019

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA “ALBPETROL”, SHA, TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, DHE TRANSFERIMIN NË FONDIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE “BAZA E TUBOVE”, ZONA KADASTRALE NR. 3934, ZHUPAN, BASHKIA FIER, SI DHE VËNIEN E SAJ NË DISPOZICION PËR ZHVILLIMIN DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “FABRIKË PËR PRODHIMIN E SISTEMEVE DHE PJESËVE ELEKTRIKE PËR AUTOMOBILË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) të pronës së paluajtshme shtetërore “Baza e tubove”, në zonën kadastrale nr. 3934, Zhupan, Bashkia Fier, kategoria e resursit “truall”, me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pasuria e paluajtshme shtetërore, e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të vihet në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “Fabrikë për prodhimin e sistemeve dhe pjesëve elektrike për automobilë”, me subjekt investues YURA Corporation Albania NUIS/NIPT: L81717032D.

3. Vënia në dispozicion e pasurisë së paluajtshme shtetërore bëhet për 60 (gjashtëdhjetë) vjet me tarifën 1 euro. Afati i përdorimit fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. E drejta e përdorimit të tokës shtetërore, të kategorisë së resursit “truall” nga ana e investitorit strategjik YURA Corporation Albania NUIS/NIPT: L81717032D, detyrimet dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr. 14/3, datë 12.2.2019, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

5. Aplikimi për leje/licenca/autorizime për realizimin e investimit strategjik “Fabrikë për prodhimin e sistemeve dhe pjesëve elektrike për automobilë” realizohet sipas legjislacionit të investimeve strategjike.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albpetrol” sh.a., Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, Bashkia Fier dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Erion Braçe

ANEKSI I
ZONA KADASTRALE NR. 3934
ZHUPAN FIER
BASHKIA FIER

ZONA E PROJEKTIT				
Nr.	Nr. pasurie	Sip. m ²	Harta sipas Nomenklaturës	Pronari
1	115/13	96.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
2	115/14	611.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
3	115/15	147.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
4	115/16	1,153.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
5	115/29	230.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
6	115/30	264.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
7	115/31	208.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
8	115/32	191.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
9	115/33	383.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
10	115/56	109.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
11	115/82	12,514.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
12	115/84	12,000.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
13	115/117	21,441.00	K-34-112-(210-D)	Shtet
TOTALI		49,347.00 m ²		



